Republika e Kosovës

Komuna e Istogut

KONTRATË PËR SHITJE

SHITJA E ASORTIMENTEVE SIPAS PLANITOPERATV

NGASTRA 051, NËNGASTRA 01 DHE

NGASTRA 016 – NËNGASTRA 02

Nr. i P 633-022-5847-1.6.10

Nr. i brendshëm 633 / 022 / 027

Neni 1 Lënda

KJO KONTRATË e lidhur më në mes të: Komuna e Istogut- Njësia e Prokurimit këtu e tutje i referuar me "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë, dhe Grupi i Operatoreve Ekonomik SHOSHANI Shpk & N T. "CHARY" me NRB, 811297458, përkatësisht, 811296004 të cilën e përfaqëson z. Zike Idrizaj, lider i grupit , (këtu e tutje i referuar si "Blerësit"), në anën tjetër:

NDËRSA Autoriteti Kontraktues ka ftuar tenderët per ofertuesit për të shprehur interesim në shitjen të aseteve, *si ne Titullin e Kontratës dhe specifikimin teknik te dosjës* dhe ka pranuar Tenderin e dorëzuar nga Blerësi për blerjen e këtyre aseteve.

TANI KJO MARRËVESHTJE DËSHMON SI NË VIJIM:

1. Blerësi pajtohet të paguaj Autoritetin Kontraktues për marrjen e Asetit, Çmimin e Kontratës në kohën dhe mënyrën e përcaktuar me Kontratë.

2. Duke konsideruar pagesat e kryera nga Blerësi, Autoriteti Kontraktues, siç theksohet në Kontratë, pajtohet të lëshoj Asetet në pajtim me dispozitat e kontratës.

3. Blerësi pagesën do ta kryeje ne pajtim me Udhezimin Administrativ si ne vijim: 40% avans pas pranim dorëzimit të ngastrës nga komisioni përkatës i Agjensionit Pyjor dhe Drejtoratit per Bujqësi, Hidroekonomi dhe Pylltari, 30% pas prerjes dhe bartjes se 50% te mases se pergjithshme drusore dhe 30% pas perfundimit te pranimit te asetit në Xh.Ll rrjedhëse Nr. 1000400070001150

4. Bleresi është i obliguar qe pagesen per parcelat ne fjale t'i bëjë për secilën ngastër veq e veq.

5. Kontrata do të permbushet ne nje afat prej 1 viti, nga data e nenshkrimit të kontratës.

Neni 2 Lokacioni i Aseteve

2.1 Lokacioni i aseteve është:

NGASTRA 051, NËNGASTRA 01; (L. i butë) Vëllimi ne m³ 368.9

NGASTRA 016 – NËNGASTRA 02; (L. I butë) Vëllimi ne m³ 1334.5

E SPECIFIKUAR NË LISTËN E ASETEVE DHE PERSHKRIMIN E ÇMIMEVE e datës: 06.07.2022 e cila është pjesë përbërese e kontrates:

2.2 Zyrtari që duhet kontaktuar për aranzhimin e marrjes së aseteve është *(do te jete i caktuar me vendim nga Njësija Kërkuese ose Zyrtari Kryesor Administrativ)*

Neni 3 Çmimi i kontratës

3.1 Çmimi total për pagesë nga blerësi pë *dyja ngastrat është*: 42.357,20 dhe me shkronja: Katërdhjetedymijëetreçindepesëdhjeteshtatë-20/100

Dru zjarri ahu 368.9 *m³* X 28,00 € = 10329,20 €;
Dru zjarri ahu 1334.5 *m³* M3 X 24,00€ = 32.028,00 €

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Blerësi i ka borxh Autoritetit Kontraktues sipas kontratës.

3.3 Çmimi do të jetë përfundimtar dhe nuk do të ndryshohet.

3.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme të kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:
(a) Marrëveshja e kontratës;
(b) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
(c) Përshkrimi i Aseteve;
(d) Tenderi i Blerësit.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Blerësit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhet me shkrim. Komunikimet do të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Blerësin.

Për Autoritetin Kontraktues: *Komuna e Istogut* *(Shitësin)*		*Për kontraktorin:* *Shoshani"Shpk & "Charly"NT* *(Blerësin)*	
Emri:	*Gëzim Ademaj*	Emri:	*Zike Idrizaj*
Pozita:	*Zyrtar përgjegës i Prokurimit*	Pozita:	*L i d e r-e*
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	
Vula:		Vula:	

PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

SHITJA E ASORTIMENTEVE DRUSORE SIPAS PLANIT OPERATIV

Nr.	NGASTRA PYJORE	LLOJI I DRURIT	CMIMI FILLESTAR	VELLIMI NE m^3	CMIMI PER m^3	TOTALI ME TVSH
	Ngastra 051 nengastra 01	ZJARRI AHU	14.47 €	368.9	28	10329.2
	Ngastra 016 nengastra 02	ZJARRI AHU	15.32 €	1334.5	24	32028
					TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT	42357.2

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
Emri i OE:	SHOSHANI SH.P.K
Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit të OE:	Zike Idrizaj
Nënshkrimi:	
Data:	06.07.2022
Vula:	

SH.P.K SHOSHANI 811297458